

**RIKONSTRUKTURA E SHQIPËRISË
DHE KOMBËTARE E NOTERISË
DHE DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MARIA M. DANO**



**DATE 21/03/2022
NR REP 1480**

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 21/03/2022, para meje Noteres MARIA M. DANO, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Mihal Duri, Nr. 4, u paraqit personalisht:

KËRKUESE:

Znj. Rezana Balla, atësia Agron, amësia Pavlina, shtetase Shqiptare, lindur në Pogradec dhe banues në Tiranë, me adresë Beqir.Luga; Nd. Nr.8; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1001; Tiranë, lindur më 01/01/1974, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035419918 dhe nr. personal H45101610D.

Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar, Kredo Finance shpk.

Unë Noterja, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta. Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja “i”, nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noteres, është e njëjtë me dokumentin origjinal. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MARIA M. DANO



**RESOLUTION OF GENERAL
SHAREHOLDERS ASSEMBLY**

**No. KREDO-SHR-2022-0004,
date 03.03.2022**

In accordance and in compliance with Article 81 paragraph 1 letter "b" of the Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On Commercial Companies" amended and in accordance with the Article 9 and 9/1 of Regulation no. 1, dated 17.01.2013 "On licensing and activity of non-bank financial institutions" approved by Supervisory Council of the Bank of Albania, Article 12/1 of the Statute of Kredo Finance and the proposal of the Chief Executive Officer,

RESOLVED:

1. To decrease the share capital of KREDO FINANCE SHPK., at value of 445,000,000 (four hundred forty-five million Albanian lekë) ALL. The reduced value of capital will be recognized as obligation for KREDO FINANCE SHPK toward shareholders. Following to this decrease, the share capital of KREDO FINANCE SHPK. is decreased to the new value of 63,936,362 (sixty-three million nine hundred thirty-six thousand three hundred sixty-two) ALL.
2. To approve Article of Association and Statute of KREDO FINANCE as per Amendments attached to this decision.
3. To authorize the company administrator to request prior approval with the Bank of Albania.
4. To authorize the company administrator to, personally or through local attorneys, file the present resolution and follow up the relevant registration procedures with the

**VENDIM I ASAMBLESE SE
PERGJITHSHME TE ORTAKUT**

**No. KREDO-SHR-2022-0004,
date 03.03.2022**

Në bazë dhe në përputhje me Nenin 81 paragrafi 1 shkronja b) të ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Ligji për Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe në bazë të Nenit 9 dhe 9/1 të Rregullores nr. 1 datë 17.01.2013 "Mbi licensimin dhe veprimtarinë e institucioneve financiare jo-bankë" i aprovuar nga Këshilli Mbikqyrës I Bankës së Shqipërisë, Neni 12/1 të Statutit të Kredo Financë dhe propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm,

VENDOSI

1. Të zvogelojë kapitalin e KREDO FINANCE SHPK., në vlerën 445,000,000 (katerqind e dyzet e pese milion Leke . Vlera e reduktuar e kapitalit do te njihet si detyrim per KREDO FINANCE SHPK ndaj Ortakëve. Pas këtij zvogelimi, kapitali i KREDO FINANCE SHPK., zvogëlohet në vlerën 63,936,362 (gjashtëdhjetë e tre million e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë e treqind e gjashtëdhjetë e dy) Lekë .
2. Miratimin e Aktit të Themelimit dhe Statutit të KREDO FINANCE sipas ndryshimeve bashkelidhur me këtë vendim.
3. Të autorizojë administratorin e shoqërisë që të kërkojë miratim paraprak, pranë Bankës së Shqipërisë sipas këtij vendimi.
4. Të autorizojë administratorin që, vetë apo duke caktuar përfaqësues të autorizuar, të depozitojë këtë vendim dhe të ndjekë procedurat e nevojshme pranë Regjistrat Tregtar sipas kërkesave të ligjit Shqiptar.

Commercial Registry ~~required~~ under
Albanian law.

5. This decision shall enter into force
immediately.

**SHAREHOLDERS ASSEMBLY
AS "Eleving Consumer Finance Holding"
OF KREDO FINANCE
Member of Board
Legal Representative**

Oskars Dzlabs

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE
AS "Eleving Consumer Finance Holding"
E KREDO FINANCE
Anëtar i Bordit
Perfaqesues Ligjor**

Oskars Dzalbs



**ARTICLES OF ASSOCIATION
AND STATUTE OF
THE
LIMITED LIABILITY COMPANY**

KREDO FINANCE SHPK

March 2022

**AKTI I THEMELIMIT
DHE STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR**

KREDO FINANCE SHPK

Mars 2022

**Article 1
Incorporation, Name**

(1) On 8 September 2021 the name of the company was changed to AS "Eleving Consumer Finance Holding", a company registered in the Republic of Latvia with registration number 40203249386, legal address Skanstes street 52, Riga, LV-1013, Latvia, pursuant to Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies", amended, (the "Company Law"), as amended.

(2) This limited liability company is registered with the Albanian commercial registry under registration number L71610009A, under the corporate name:

KREDO FINANCE SHPK. (hereinafter the "Company")

**Article 2
Purpose of the Company**

(1) The purpose of the Company shall be the performance of the activity of a microfinance credit institution pursuant to the applicable legislation and the licenses obtained by the competent authorities prescribed by law. The purpose of the Company shall include the rendering of counselling and other ancillary services to the main activity, as prescribed by law.

(2) The Company may additionally perform other financial non – banking activities, pursuant to licenses obtained by the authorities prescribed by law.

(3) The Company may establish or own participations in other companies, collaborate or enter into *joint – ventures* or other similar agreements with other companies having the same, a similar or related purpose with the purpose of the Company.

(4) The Company may perform financial transactions related to movable and immovable properties, as well as to guarantee its own and third party obligations, and provide guarantees over its properties pursuant to the law.

**Neni 1
Themelimi, Emri**

(1) Më 8 Shtator 2021 emri i shoqërisë u ndryshua në, AS "Eleving Consumer Finance Holding", një kompani e regjistruar në Republikën e Letonisë me regjistracionin numër 40203249386, me adresë Skanstes street 52, Riga, LV-1013, Letoni në përputhje me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar (në vijim "Ligji Tregtar"), i ndryshuar..

(2) Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar është e regjistruar në regjistrin tregtar Shqiptar, me numër unik L71610009A, dhe ushtron aktivitetin e saj me emrin e regjistruar:

KREDO FINANCE SHPK. (në vijim "Shoqëria")

**Neni 2
Objekti i Shoqërisë**

(1) Objekti i Shoqërisë do të jetë kryerja e aktivitetit financiar të mikrokredisë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencat e dhëna nga autoritetet e caktuara me ligj. Objekti i Shoqërisë do të përfshijë dhënie të shërbimeve këshilluese dhe shërbime të tjera ndihmëse për të aktivitetin kryesor, sipas parashikimeve të ligjit.

(2) Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu aktivitete të tjera financiare jo-bankare, në përputhje me licencat e dhëna nga autoritetet e caktuara me ligj.

(3) Shoqëria mund të themelojë apo zotërojë pjesëmarrje, të bashkëpunojë, të lidhë marrëveshje *joint – venture* a marrëveshje të ngjashme me shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo të lidhur me objektin e Shoqërisë.

(4) Shoqëria mund të kryejë transaksione financiare, transaksione me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të garantojë detyrimet e veta apo ato të palëve të treta, të vendosë garanci mbi pasuritë e saj sipas ligjit.

**Article 3
Duration**

The Company is incorporated for an indefinite period of time.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

Shoqëria themelohet për një periudhë kohe të papërcaktuar.

**Article 4
Fiscal Year, Financial Statements**

(1) The fiscal years are defined as the calendar years.

(2) The financial statements have to be drawn up and signed by all managing directors for submission and approval by the general meeting, within the stipulated statutory period.

**Neni 4
Viti Financiare, Pasqyrat Financiare**

(1) Vitet financiare janë të përcaktuara si vitet kalendarike.

(2) Pasqyrat financiare duhet të hartohen dhe nënshkruhen nga të gjithë administratorët, për paraqitje dhe miratimin nga asambleja brenda afatit ligjor.

**Article 5
Registered Office**

(1) The registered office of the Company shall be in Tirana, Albania. The address of the registered office of the Company is determined in Annex 1 attached hereto as integral part of this Statute.

**Neni 5
Selia**

(1) Shoqëria do ta ketë selinë e saj në Tiranë, Shqipëri. Adresa e selisë së Shoqërisë shënohet në Aneksin 1 bashkëlidhur si pjesë përbërëse e këtij Statuti.

**Article 6
Registered Capital**

(1) The registered capital of the Company is ALL 63,936,362 (sixty three million nine hundred thirty-six thousand three hundred sixty two) It is divided in shares as determined in Annex 2 attached hereto as integral part of this Statute.

**Neni 6
Kapitali i Regjistruar**

(1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë është Lekë 63,936,362 (gjashtëdhjetë e tre milion e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë e treqind e gjashtëdhjetë e dy) Lekë. Kapitali ndahet në kuota të shënuara në Aneksin 2, pjesë përbërëse e Statutit.

**Article 7
Shareholders of the Company**

(1) The shareholders of the Company are the persons that have acquired its shares pursuant to the law. The Company shares may be also in co-ownership between more than one person. The shareholders of the Company are determined in Annex 2 attached hereto as integral part of this Statute.

(2) The persons that co-own a Company share shall mutually determine in a written agreement their respective rights and obligations relating to their share, provided that in relations with the Company these persons shall be treated as one single shareholder, and the respective rights

**Neni 7
Ortakët e Shoqërisë**

(1) Ortakët e Shoqërisë janë personat që kanë fituar kuota të kapitalit të saj në përputhje me parashikimet e ligjit. Kuota të Shoqërisë mund të zotërohen edhe në bashkëpronësi mes më shumë se një personi. Ortakët e Shoqërisë shënohen në Aneksin 2, pjesë përbërëse e Statutit.

(2) Personat që zotërojnë në bashkëpronësi një kuota të kapitalit të Shoqërisë, merren vesh me marrëveshje të shkruar ndërmjet tyre për ndarjen e të drejtave e të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kuota, por në marrëdhënie me Shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre

attached to their share shall be exercised by a common representative appointed by them.

(3) The Co-owners of a Company share are jointly and severally liable toward the Company for the obligations attached to their share, and the actions of the Company in relation to the share will have effect as against all co-owners, even if the action was addressed to only one of them.

(4) The Company shall maintain an updated registry of its shareholders. In addition to any disclosure obligations to the relevant authorities pursuant to the law, any transaction related to the company shares shall be notified to the directors and entered into the registry of shareholders.

(5) No encumbrances may be established over shares of the Company without the prior approval of the Shareholders' Assembly.

Article 8 Amendments to the Share Capital, Purchase of Own Shares

(1) The general meeting may resolve to increase or decrease the share capital of the Company pursuant to the Company Law.

(2) The Company may not purchase its own shares, unless the purchase is immediately followed by the cancellation of the share and the decrease of the share capital.

Article 9 New Contributions

(1) The subscription and payment of further contributions in cash shall be completed not later than the term decided in the resolution passing the increase.

(2) The subscription and payment of further contributions in kind shall be completed prior to the registration of the capital increase at the commercial registry. The evaluation of the contributions in kind shall be performed pursuant to the Company Law.

Article 10 Transfer of Shares

ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët të caktuar prej tyre.

(3) Bashkëzotëruesit e një kuote përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës, dhe veprimet e Shoqërisë ndaj kuotës krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej tyre.

(4) Shoqëria mban një regjistër të përditësuar të ortakëve të saj. Përveç detyrimeve për njoftim pranë autoriteteve përkatëse sipas ligjit, çdo transaksion në lidhje me kuotat i njoftohet administratoreve të Shoqërisë dhe regjistrohet në regjistrin e ortakëve.

(5) Asnjë barrë nuk mund të vendoset mbi kuotat e Shoqërisë pa miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 8 Ndryshimet e Kapitalit, Blerja e Kuotave të Veta

(1) Asambleja e ortakëve mund të vendosë të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë sipas Ligjit Tregtar.

(2) Shoqëria nuk mund të blejë kuotat e saj, përveçse kur Shoqëria anulon kuotën, dhe zvogëlon kapitalin, menjëherë pas blerjes.

Neni 9 Kontributet e Reja

(1) Nënshkrimi dhe shlyerja e kontributeve të mëtejshme në para do të kryhet brenda afatit të përcaktuar në vendimin që miraton zmadhimin.

(2) Nënshkrimi dhe shlyerja e kontributeve të mëtejshme në natyrë do të kryhet përpara regjistrimit të rritjes së kapitalit pranë regjistrin tregtar. Vlerësimi i kontributeve në natyrë do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.

Neni 10 Transferimi i Kuotave

(1) The transfer of the Company shares shall be made in writing, and in compliance with the requirements of the Company Law.

(2) The general meeting may resolve to split a share for the purpose of its partial transfer, as well as determine conditions for the transfer of shares to third parties, including pre-emption rights in favour of existing shareholders, except for those already provided in these Articles of Association.

(3) For as long as AS "Eleving Consumer Finance Holding" ("Eleving Consumer Finance Holding") will own the majority of the shares of the Company, any transfer of shares of the Company from another shareholder (the "transferring shareholder") to an unrelated third party, shall be subject to the right of first refusal of Eleving Consumer Finance Holding, to be exercised according to the below procedure:

3.1 The transferring shareholder shall deliver to Eleving Consumer Finance Holding and the Company a written notice on the sale of its share in the Company ("transferred share") together with a legally binding share purchase agreement that does not include a free withdrawal (cancellation) option for the third-party buyer and inform Eleving Consumer Finance Holding about its right of first refusal;

3.2 If Eleving Consumer Finance Holding has decided to exercise its right of first refusal, it must notify in writing the transferring shareholder and the Company within 30 (thirty) days as of the receipt of the transferring shareholder notice on the sale of the share. In such case Eleving Consumer Finance Holding shall replace the buyer in the share purchase agreement and purchase the transferred share based on the same terms and conditions, except for the share purchase price, which shall be calculated in accordance with the shareholders agreement entered into between the shareholders of the Company.

3.3 If Eleving Consumer Finance Holding does not exercise its right of first refusal and/or does not notify the transferring shareholder and the Company about its decision on exercise of its right of first refusal, the transferring

(1) Transferimi i kuotave do të bëhet me shkrim, dhe në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

(2) Asambleja e ortakëve mund të vendosë ndarjen e një kuote, me qëllim transferimin e pjesëshëm të saj, si dhe kushte për transferimin e kuotave të Shoqërisë ndaj të tretëve, përfshi këtu të drejtën e parablerjes në favor të ortakëve ekzistues, përveç atyre të parashikuara në këtë Statut.

(3) Për sa kohë AS "Eleving Consumer Finance Holding" ("Eleving Consumer Finance Holding") do të zotërojë shumicën e kuotave të Shoqërisë, çdo transferim i kuotave të Shoqërisë nga një ortak tjetër ("ortaku transferues") tek një person i tretë, do t'i nënshtrohet të drejtës së parablerjes së Eleving Consumer Finance Holding, e cila do të ushtrohet sipas procedurës së mëposhtme:

3.1 Ortaku transferues do t'i dërgojë Eleving Consumer Finance Holding dhe Shoqërisë një njoftim me shkrim për transferimin e kuotës së tij në Shoqëri ("kuota e transferuar") së bashku me një marrëveshje detyruese për shitjen e kuotës që nuk përfshin një të drejtë tërheqjeje (anulimi) pa penalitet për blerësin dhe do të njoftojë Eleving Consumer Finance Holding lidhur me të drejtën e tij të parablerjes;

3.2 Nëse Eleving Consumer Finance Holding ka vendosur të ushtrojë të drejtën e parablerjes, ai duhet të njoftojë me shkrim ortakun transferues dhe Shoqërinë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të ortakut transferues për shitjen e kuotës. Në këtë rast Eleving Consumer Finance Holding do të zëvendësojë blerësin në marrëveshjen për shitjen e kuotës dhe do të blejë kuotën e transferuar me të njëjtat kushte dhe afate, përjashtuar çmimin e shitjes, i cili do të llogaritet në përputhje me kushtet e marrëveshjes së ortakëve lidhur mes ortakëve të Shoqërisë.

3.3 Nëse Eleving Consumer Finance Holding nuk ushtron të drejtën e parablerjes dhe/ose nuk njofton ortakun transferues dhe Shoqërinë lidhur me vendimin e tij për të ushtruar të drejtën e parablerjes, ortakun

shareholder can sell the transferred share to the third-party buyer, provided that the third-party buyer accedes to the provisions of the shareholders agreement entered into between the shareholders of the Company and that the transferring shareholder has complied with its obligations under the shareholders agreement in relation to the transfer of its share.

Article 11 Distribution of Profits

(1) The Company may only make a distribution to its shareholders, of profits available under its financial statements, if, after payment of the distribution:

a) the Company's assets will fully cover its liabilities, and

b) the Company will have sufficient liquid assets to make payments for its liabilities as they fall due in the next twelve months.

(2) The managing directors shall issue a 'solvency certificate', which explicitly confirms that the proposed distribution meets the valuation as of paragraph 1. Where the accounts of the company indicate that the proposed distribution cannot meet the valuation of paragraph 1, the managing directors may not issue the solvency certificate.

Article 12 Audit Committee

(1) The Company shall have an Audit Committee

(2) The Audit Committee is comprised of the Chairman and two members whom are appointed by the Shareholders' Assembly for a 4 year mandate, with the right to re-election and shall have the following duties:

a) monitors and supervises accounting procedures and internal control of the company, including the procedures defined by the Bank of Albania, and supervises the implementation of these procedures as well as audits the company's activity and respective registrations;

transferues mund t'i shesë kuotën e transferuar blerësit të tretë, me kusht që ai të aderohet në parashikimet e marrëveshjes së ortakëve lidhur mes ortakëve të Shoqërisë dhe me kusht që ortaku transferues të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e tij sipas marrëveshjes së ortakëve lidhur me transferimin e kuotës.

Neni 11 Shpërndarja e Fitimit

(1) Shoqëria mund t'u shpërndajë ortakëve fitimet e disponueshme sipas pasqyrave financiare, vetëm nëse pas pagimit:

a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

(2) Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Neni 12 Komiteti i Auditit

(1) Shoqëria do të ketë një Komitet Auditit.

(2) Komiteti i Auditit përbëhet nga një Kryetar dhe dy anëtarë të cilët emërohen nga Asambleja e Ortakëve për një mandat 4-vjeçar me të drejtë ri-zgjedhje dhe do të ketë këto detyra:

a) monitoron dhe mbikqyr procedurat e kontabilitetit dhe kontrollit të brendshëm të shoqërisë, përfshirë edhe procedurat e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë, dhe mbikqyr dhe zbaton këto procedura si dhe auditon veprimtarinë e shoqërisë dhe regjistrimet respective;

b) considers internal audit reports and monitors the way conclusions from such reports are dealt with;

b) konsideron raportet e auditit dhe monitoron mënyrën sesi ndiqen konkluzionet e raporteve;

c) proposes the statutory auditor and realizes the communication between him and the internal audit of the company;

c) propozon auditorin e jashtëm dhe realizon komunikimin midis tij dhe auditit të brendshëm të shoqërisë;

d) evaluates the financial situation of the company based on the report of the statutory auditor;

d) vlerëson situatën financiare të shoqërisë, bazuar në raportet e auditorit të jashtëm;

e) ensures compliance of the activity of the company with laws and by-laws and notifies the Shareholder Assembly about the conclusions;

e) siguron përputhshmërinë e aktivitetit të shoqërisë me ligjet dhe aktet nënligjore dhe njofton Asamblesën e Ortakëve rreth konkluzioneve;

f) prepares and delivers opinions to the Shareholder Assembly in relation to issues, for which the latter has requested such opinion;

f) përgatit dhe shpërmdan opinione të Asamblesës së Ortakëve, në lidhje me çështjet për të cilat këta të fundit kanë kërkuar opinion;

g) proposes the financial reports and statements prepared by the company and approves the one the company intends to publish;

g) propozon raporte financiare dhe pasqyra të përgatitura nga shoqëria dhe i aprovon pasqyrat që shoqëria synon të publikojë;

(3) The Audit Committee shall meet ordinarily once per quarter and extraordinarily when convened by the Shareholder Assembly. Decisions shall be taken by the Chairman.

(3) Komiteti i Auditit zakonisht do të mbledhet një herë në tre muaj dhe në mënyrë të jashtëzakonshme kur të jetë e nevojshme nga Asambleja e Ortakëve. Vendimi do të merret nga Kryetari.

(4) The Meetings of the Audit Committee shall be chaired by the Chairman. The Chairman is appointed for the entire duration of his/her mandate and can be re-appointed.

(4) Mbledhjet e Komitetit të Auditit do të kryesohen nga Kryetari i tij. Kryetari emerohet për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit të tij/saj dhe mund të ri-zgjidhet.

(5) The Audit Committee meetings are convened by the Chairman. The call shall be made 7 (seven) days before the meeting in person, telephonically by voice or facsimile, by video conference, telex, electronic mail, or by similar electronic means. Any call includes the proposed agenda of the meeting.

(5) Mbledhjet e Komitetit të Auditit thirren nga Kryetari i tij. Thirrja duhet të bëhet 7 (shtatë) ditë para mbledhjes personalisht, nëpërmjet telefonit, zërit, ose faksit, video konferencë, telex, postës elektronike, ose mjete të tjera të ngjashme elektronike. Çdo thirrje përfshin axhendën e propozuar të mbledhjes.

(6) Meetings of the Audit Committee may be held either within or outside the Republic of Albania, and may be conducted in person, telephonically by voice or facsimile, by video conference, telex, electronic mail, or by similar electronic means upon condition that each attendant (i) may be identified by the other attendants, (ii) be previously informed about the issues of the agenda, (iii) may follow the discussion and (iv) may intervene in real time.

(6) Mbledhjet e Komitetit të Auditit mund të mbahen si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë dhe mund të kryhen personalisht, nëpërmjet telefonit ose zërit, ose faksit, video konferencë, telex, postës elektronike, ose mjete të tjera të ngjashme elektronike sipas kushteve që çdo pjesëmarrës (i) mund të identifikohet nga pjesëmarrësit e tjerë, (ii) të jetë i informuar paraprakisht rreth çështjeve të axhendës, (iii)

If such conditions are met, the meetings shall be considered as having been held in the place where the Chairman and the secretary of each meeting are present.

(7) The minutes of the meetings of the Audit Committee and its decisions are kept by the secretary and signed by him/her and by the Chairman of the Audit Committee. The secretary is appointed by the Chairman of the Audit Committee. The minutes are kept in a special register.

(8) Upon its request, The Audit Committee may be assisted by experts appointed by the Shareholder Assembly of the company.

(9) The Assembly Shareholders' meeting of the company may decide remuneration for membership of the Audit Committee.

(10) The Audit Committee reports to the Shareholder Assembly and assists the latter in the company's decision-making and supervisory process.

të mund të ndjekë diskutimet dhe (iv) të mund të ndërhyjë në kohë reale. Nëse këto kushte plotësohen mbledhjet do të konsiderohen si të mbledhura në vendin ku Kryetari dhe sekretari i cdo mbledhje janë prezent.

(7) Minutat e mbledhjeve të Komitetit të Auditit dhe vendimet e tij mbahen nga sekretaria dhe firmosen prej saj dhe nga Kryetari i Komitetit të Auditit. Sekretari emërohet nga Kryetari i Komitetit të Auditit. Minutat mbahen në një regjistër të veçantë.

(8) Sipas kërkesës së tij Komiteti i Auditit mund të ndihmohet nga ekspertë të caktuar nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.

(9) Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë mund të vendosë pagesën e pjesëmarrjes në Komitetin e Auditit.

(10) Komiteti i Auditit i raporton Asamblesë së Ortakëve dhe asiston këtë të fundit në vendimmarrje të shoqërisë dhe procesit të mbikqyrjes.

Article 13

Managing Directors, Appointment, Dismissal and Powers

(1) The Company is managed by one or more managing directors appointed by the general meeting, for a term not exceeding 5 years, with the possibility of renewal. The act of appointment of the managing directors shall contain the term of office as well as any limitation to their legal representation powers in compliance with the Company Law.

(2) The general meeting may dismiss the managing directors (all of them or each individually) at any time.

(3) The managing directors shall have the rights, powers and duties to perform actions provided in the Company Law.

(4) The general meeting may set forth detailed provisions on the duties of the managing directors, as well as internal procedure rules for the management of the company, including prior consultation with and/or approval by

Neni 13

Administratorët, Emërimi, Shkarkimi dhe Kompetencat

(1) Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të emëruar nga asambleja e ortakëve, për një afat jo më të gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Akti emërimit të administratorëve do të përmbajë afatin e emërimit të tyre si dhe çdo kufizim të kompetencave të përfaqësimit në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

(2) Asambleja e ortakëve mund të shkarkojë administratorët (të gjithë ose secilin individualisht) në çdo kohë.

(3) Administratorët kanë të drejtat, kompetencat dhe detyrën të kryejnë veprimet e parashikuara në Ligjin Tregtar.

(4) Asambleja e ortakëve mund të përcaktojë dispozita të detajuara mbi detyrat e administratorëve, si dhe rregulla të brendshme procedurale për realizimin e administrimit të Shoqërisë, përfshirë

Shareholder representatives, with respect to determined actions, and the managing directors shall comply with the rules and the procedure that have been approved by the general meeting.

konsultime me dhe/ose miratime paraprake nga përfaqësues të ortakëve, në lidhje me veprime të caktuara, dhe administratorët detyrohen të zbatojnë rregullat e procedurat të miratuara nga asambleja.

Article 14 Remuneration

(1) The Company shall remunerate managing directors pursuant to the agreed terms, and in compliance with the provisions of the Company Law.

Neni 14 Shpërblimi

(1) Shoqëria shpërblen administratorët sipas kushteve të marrëveshjeve të rëna dakord, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.

Article 15 Representation

(1) Unless the general meeting resolves otherwise, and within the rights and duties provided in article 12(1) hereof, each managing director shall have unrestricted power to solely represent the Company in relationships with third parties, including any public authority and the judiciary.

Neni 15 Përfaqësimi

(1) Përveç rastit kur asambleja e ortakëve vendos ndryshe, dhe brenda të drejtave dhe detyrave të parashikuara në nenin 12(1) më sipër, secili administrator do të ketë kompetencë të pakufizuar për të përfaqësuar i vetëm Shoqërinë në marrëdhëniet me palët e treta, përfshirë çdo autoritet publik dhe gjyqësor.

Article 16 The General Meeting and Voting Rights

(1) The general meeting of shareholders is the highest governing body of the Company, and it exercises the rights and duties determined by the Company Law.

Neni 16 Asambleja e Ortakëve, të Drejtat e votës

(1) Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë, dhe ushtron të drejtat e detyrimet e përcaktuara sipas Ligjit Tregtar.

(2) The general meeting is convened, holds valid meetings and passes valid resolutions in accordance with the Company Law.

(2) Asambleja e ortakëve thirret, mban mbledhje të vlefshme dhe miraton vendime të vlefshme në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

(3) Each share carries a number of votes equal to the portion of the share capital it represents. Co-owners of a share shall jointly exercise the voting rights carried by their share, through the common representative appointed pursuant to Article 7 of this Statute.

(3) Secila kuotë ka një numër votash të barabartë me pjesën që ajo zë në kapitalin e Shoqërisë. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë bashkërisht të drejtat e votës, nëpërmjet përfaqësuesit të përbashkët të caktuar prej tyre sipas nenit 7 të këtij Statuti.

